

AKT- MARRËVESHJE

Datë 14.07.2022

Sot, në datë 14.07.2022, nënshkruhet Akt-Marrëveshja midis palëve si më poshtë:

Pala e parë: Z.Artan Gaçi, atësia Ilia, dtl.14.05.1969, në cilësinë e ortakut zotërues të 30% të kuotave të kapitalit të Shoqërisë “RAKEHA” Shpk

Dhe

Pala e dytë: Z.Festim Çela, atësia Bajram, dtl.22.11.1987, ID nr.personal I71122039Q, në cilësinë e Personit të besuar.

Duke qenë se ekzistojnë faktet e mëposhtme:

- Z. Artan Gaçi është ortak zotërues i 30% të kuotave në Shoqërinë “RAKEHA” sh.p.k. me NUIS K71415008J
- Në datën 13.07.2022 jemi vënë në dijeni se Shoqëria “RAKEHA” sh.p.k. rezulton me status AKTIV në QKB megjithëse nga data 09.07.2010 ka satus PASIV në Drejtorinë e Përgjithëshme të Tatimeve.
- Z. Artan Gaçi cakton Z.Festim Çela, si **Person të Besuar**.
- Z. Festim Çela shpreh pëlqimin dhe deklaron se pranon caktimin si Person i Besuar.

Me vullnet të lirë e të plotë Palët deklarojnë se, kanë vendosur të hartojnë Akt-Marrëveshjen me përbajtjen si më poshtë, në bazë të Nenit 3 pka 6 dhe Nenit 35 i Ligjit 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”

NENI 1

Objekti i Akt-Marrëveshjes

Objekt i kësaj Akt-Marrëveshje është caktimi i Z.Festim Çela në cilësinë e Personit të Besuar të ortakut Z.Artan Gaçi, në Shoqërinë “RAKEHA” sh.p.k. me nunëri identifikimi NUIS K71415008J, në përputhje me Nenin 27 dhe 35 të Ligjit Nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar si dhe tagrave të specifikuara si më poshtë, si pasojë e humbjes së cilësisë si “**Zotërues aktiv i kuotave**”, që ai zotëron në shoqëri, nëpërmjet transferimit të tyre dhe kalimit në cilësinë e “**Zotëruesit pasiv të kuotave**”

NENI 2

Afati i Akt-Marrëveshjes

Kjo Akt- Marrëveshje do të jetë në fuqi, sipas Ligjit Nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

NENI 3

Të drejtat dhe detyrimet e Palëve

- Me qëllim menaxhimin e aktivitetit të shoqërisë së mësipërme, nga momenti i nënshkrimit të kësaj Akt- Marrëveshje, ortaku Z.Artan Gaçi i kalon në mënyrë individuale Personit të Besuar, të drejtën e vendimmarjes mbi kuotat e zotëruara prej tij në këtë shoqëri.
- Menaxhimi dhe administrimi nga Person i Besuar do të bëhet sipas legjislacionit në fuqi, por pa të drejtën e tjeterismit të tyre. Gjithashtu me nënshkrimin e kësaj Akt-Marrëveshje, ortaku Z.Artan Gaçi humbet cilësinë si “Zotëruesh aktiv i kuotave”, që zotëron ne shoqërinë e mësipërme, duke kaluar në “Zotëruesh pasiv të kuotave të saj”.
- Z. Artan Gaçi, pavarësisht kalimit në “Zotëruesh pasiv të kuotave” të tij, gjëzon të drejtën e përfitimit të fryteve civile të pronësisë që gjëzon mbi kuotat e tij në shoqëri, por në çdo rast, nuk mund të ushtronë asnjë veprim tjetër mbi këto pasuri.
- Personi i Besuar detyrohet të mos shkëmbejë asnjë informacion me ortakun e shoqërisë dhe të mos ndikohet nga ai në kryerjen e veprimeve me pasuritë e shoqërisë dhe mbarëvajtjen e aktivitetit të saj.
- Personi i Besuar detyrohet të veprojë vetëm në të mirën e ruajtjes së pasurive të shoqërisë më të njëtin motivim sikur këto veprime të kryheshin nga vetë ortaku i saj, duke vepruar në mirëbesim.
- Palët detyrohen të kryejnë depozitim e kësaj Akt-Marrëveshje pranë QKB-së, në të dhënat e shoqërisë së sipërcituar, si dhe pranë çdo institucioni shtetëror ku depozitimi i këtij akti është detyrim ligjor sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

NENI 5

Shpërblimi

Palët bien dakord që, shpërblimi për shërbimin që do të kryhet nga Personi i Besuar do të vendoset me marrëveshje midis tyre.

NENI 6


Të ndryshme

Kjo Akt-Marrëveshje u hartua me vullnetin e të dyja palëve në katër kopje.

Për sa nuk është parashikuar si më sipër, palët do t'i referohen dispozitave ligjore të parashikuara në Kodin Civil dhe Ligjin Nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe çdo ligji tjetër në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Pala e parë

ZARTAN GAÇI



Pala e dytë

Z.FESTIM ÇELA

